



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:048299

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05776860

KPPP.nr. 1417/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Rexha Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810515223 dhe me seli në Prishtinë, Kroi i Bardhë, Llamella 1, Lokali 107, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 16/2021 të datës 18.01.2021, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli me seli Ferizaj, jashtë seancës, me datë 04.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK ashtu që Urdhri përmbartimor P.nr. 16/2021 i datës 18.01.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Rexha Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 16/2021 të datës 18.01.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit faturë nr. 18-210-001-10 të datës 27.07.2018, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 72,853.25 EUR (shtatëdhjetë e dymijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre euro, e njëzet e pesë euro cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se debitori, lidhur me borxhin e pretenduar, kreditori paraprakisht kishte iniciuar edhe më parë propozim për përmbartim tek përmbartuesi Atip Mustafa i cili ishte

anuluar me aktvendimin PPP.nr. 1648/18 të datës 18.06.2019. Tutje, ka shtuar se kreditori, përsëri ka paraqitur propozim për përmbarim pranë përmbaruesit privat Fadil Hoxha, ndërsa debitori, ka ushtruar prapësim ndaj urdhrat për lejimin e përmbarimit, por që debitori, ende nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me vendimin mbi prapësimin. Ka sqaruar se kreditori në faturë ka përmendur punët shtesë, por nuk ka bashkangjitur asnjë dokument me të cilën provohen kryerja e punëve të tilla për debitorin.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar se qëndron fakti se kreditori ka iniciuar më parë dy procedura përmbarimore lidhur me borxhin sipas faturës kontestuese, ku gjykata ka shfuqizuar urdhrat përmbarimor të lëshuar nga Përmbaruesit Privat Atip Mustafa, respektivisht Fadil Hoxha. Ka sqaruar se kreditori, duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatave, ka evituar të metat dhe parregullsitë ashtu që ka iniciuar përsëri procedurën përmbaarimore tanimë pranë përmbaruesit privat Mubarak S. Shumolli. Ka theksuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi i plotëson të gjitha kushtet ligjore për të qenë e përshtatshme për përmbarim, pasi që e njëjta i përmban elementet nga neni 29 i LPP-së dhe si e tillë është e pranuar nga debitori. Gjykatës i ka kërkuar që prapësimi i debitorit të pranohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të refuzohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti faturë nr. 18-210-001-10 e datës 27.07.2018 në bazë të së cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që debitori ka pranuar faturën e lartcekur duke u pajtuar me detyrimin që derivon nga fatura e lartcekur.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që lidhur me borxhin në vlerë prej 72,853.25 EUR janë zhvilluar dy procedura përbarimore dhe atë pranë Përbaruesit Privat Atip Mustafa sipas urdhrorit përbarimor P.nr. 737/18 të datës 05.11.2018 si dhe pranë Përbaruesit Privat Fadil Hoxha sipas urdhrorit përbarimor P.nr. 45/20 të datës 14.02.2020, e në të cilat procedura, debitori vazhdimisht ka kundërshtuar faturën e lartcekur së bashku me detyrimin që derivon nga kjo faturë. Pra, nga vet qëndrimi i debitorit i shprehur qysh në procedurën përbarimore të vitit 2018, respektivisht vitit 2020, rezulton se i njëjti nuk ka shprehur pajtueshmëri me detyrimin që është përcaktuar në faturën e lartcekur. Andaj fakti që kreditori për herë të tretë ka arritur që faturën kontestuese ta dorëzoj tek debitori, nuk e bën të njëjtën të përshtatshme për përbarim përderisa debitori veçse e ka kundërshtuar faturën kontestuese në procedurën përbarimore sipas Urdhrit P.nr. 737/18 të përfunduar me aktvendimin PPP.nr. 1648/18 të datës 18.06.2019 dhe procedurën përbarimore sipas urdhrorit P.nr. 45/20 të datës 14.02.2020 në të cilën procedurë kreditori kishte tërhequr propozimin për përbarim.

Gjykata rikujton se dorëzimi i faturës tek debitori qoftë përmes zyrës së pranimit të shkresave apo në ndonjë formë tjetër të përshtatshme të komunikimit dhe pranimit i saj nga debitori nuk paraqet vetëm element formal të faturës si dokument i besueshëm, por duhet të shpreh pajtueshmërinë e debitorit se i njëjti është njoftuar me detyrimin nga fatura dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar. Ndërsa, siç u sqarua më lartë, debitori faturën kontestuese e ka kundërshtuar vazhdimisht, dhe atë në dy procedura përbarimore të zhvilluara ndaj tij.

Në anën tjetër, gjykata gjen se fatura e lartcekur nuk përcakton në mënyrë të qartë as objektin e detyrimit të saj, pasi që fatura rezulton se është lëshuar në emër të “punëve shtesë” ndërsa përkundër faktit që kreditori ka paraqitur kërkesë tek debitori për njohjen e punëve shtesë, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë se këto punë shtesë janë aprovuar, ashtu që detyrimi në vlerë prej 72,853.25 EUR sipas faturës nr. 18-210-001-10 të datës 27.07.2018 të bëhet i arritshëm. Andaj, një faturë e njëanshme e lëshuar nga kreditori, lidhur me një punë apo shërbim i cili nuk është konfirmuar nga pala debitore, nuk mund ta vë në detyrim palën debitore për pagesën e saj.

Përkundër kësaj, kreditori nuk ka asnjë pengesë ligjore që lidhur me pretendimet për kompensim në emër të punëve shtesë, të inicioj procedurë të veçantë kontestimore.

Si përfundim, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1417/23 datë 04.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.